



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KZAZ-VE NR.26, NR.40 DHE SEKRETARIT KRYESISHT TË KZAZ-SË NR.42 PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 27.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për lirim dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve nr.26, nr.40 dhe sekretarit kryesisht të KZAZ-së nr.42 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 30, neni 31, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

- Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, me shkresat nr. 12461, datë 27.06.2019, ka kërkuar:

- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 26, z. Alban Memaj dhe emërim të zj. Adelina Bardhoshi;
- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 40, z. Kreshnik Laknori dhe emërim të z. Renato Kalemi;

Me shkresën nr. 12452 prot., datë 27.06.2019, sekretarja e KZAZ nr. 42, zj. Jonida Qerosi, emëruar kryesisht nga KQZ me vendimin nr. 670, datë 28.05.2019 për arsye objektive ka kërkuar dorëheqjen.

Nr. 901 i Vendimit Data 27.06.2019 e Vendimit Ora 14:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve nr.26, nr.40 dhe sekretarit kryesisht të KZAZ-së nr.42 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.



Në listën e shtetasve miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, pas plotësimit të vakancave të KZAZ me emërimet kryesisht nga KQZ, nuk rezultojnë shtetas të paemëruar me vendbanim në Bashkinë Kavajë.

Në shqyrtim të kërkesave të shtetasve, në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, por që për shkak të paraqitjes në tejkalim të afatit, nuk janë bërë pjesë e lidhjes 1 të vendimit nr. 140, datë 09.04.2019, rezulton se shtetasi Irej Çeka, me vendbanim në Bashkinë Kavajë, dhe arsim juridik, plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor për tu emëruar sekretar i KZAZ nr. 42.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 30, nenin 31, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve sipas lidhjes 1.
2. Të emërojë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve sipas lidhjes 2.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 901 i Vendimit Data 27.06.2019 e Vendimit Ora 14:00 e Vendimit

Për lirimin dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve nr.26, nr.40 dhe sekretarit kryesisht të KZAZ-së nr.42 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.